



**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL IV/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së IV (katër) për vitin 2026 të Komitetit për Komunitete Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 27.04.2026
Ora : 09:00

Prezentë:

Znj. Shkendije Shabanaj-Kryesuese
z.Nazim Shabanaj
znj.Merita Basha
z.Zek Berisha
znj.Amira Sofra
z.Aziz Bytyqi

Të pranishëm tjerë:

Xheladin Sadikaj- Zyrtar për Kthim dhe Komunitete
Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Zyra për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesja e cila propozoi këtë:

Rend Dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për DKA-në;

3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë;

4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin e komisionit për shqyrtimin e shpërblimeve “ Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjes “13 Qershori”,

5.Të ndryshme;

Kryesuesja- Përhëndet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e dites:

Unanimisht miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesja- e hedhë në votim pikën 1

Unanimisht miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për DKA-në;

Kryesuesja- e elaboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyçi-përhendetje për të gjithë.Komisioni është obligim ligjor nga rregullorja për qështjen e përzgjedhjes së Drejtorëve Zëvendës drejtorëve dhe mësimëdhënesve të Shkollave të mesme dhe të ulëta në Republikën e Kosovës,DKA ka vlerësu dhe ka konsideru se Begishe Basha i plotëson kushtet dhe kriterët që të jetë njëra nga përfaqësuesit e DKA-së dhe Jeton Vranovci Drejtor i Shkollës me performancë të lartë ndërsa anëtari i tretë vjen nga Ministria e Arsimit dhe dy anëtar jan njëri nga Këshilli i prindërve dhe njëri nga mësimëdhënsit në cilësi të vëzhgimit pa të drejtë vote.

Kryesuesja- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë;

Kryesuesja- e elaboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyçi-e kemi obligim ligjor ta formojm komisionin për shqyrtimin e aplikacionit për ndarjen e bursave për student dhe nxënës si dhe komisionin për shqyrtimin e ankesave,ky komision është në përbërje prej 3 anëtareve nga Kuvendi i Komunës dhe 2 nga Ekzekutivi.

Kryesuesja-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin e komisionit për shqyrtimin e shpërblimeve “ Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjes “13 Qershori”,

Kryesuesja-e elaboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyçi-e kemi obligim ta formojm komisionin për të bër shqyrtimin dhe nominimin e propozimeve që vijn nga qytetarët,institucionet,shoqatat dhe kryesit e fshatërave lidhur me propozimet e tyre.Komisioni do të jetë prej 7 anëtarëve.

Kryesuesja- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Takimi përfundoi: 9:10

